



# Qyteti im

falas

**Vjeshta e artë e Kolonisë Ndërkombëtare të Piktoreve në edicionin e tretë  
Qytetarët pjesë e vendimmarrjes në takimet e Buxhetimit me Pjesëmarrje  
YES, Stimulojmë sipërmarrësit e rinj**

Botim i Bashkisë Korçë SHTATOR –TETOR 2009



**KORÇA KU  
DUA TE JETOJ**

# Buxhetimi me pjesëmarrje

## Zhvillohen takimet e hapura me qytetarët



**N**ë prag të përgatitjes së projektbuxhetit për investimet e vitit 2010, Bashkia e qytetit edhe këtë vit zhvilloi takimet e hapura me qytetarët sipas projektit "Buxhetimi me pjesëmarrje".

Sipas një grafiku, takimet vijuan përgjatë një jave me të gjithë banorët, të cilët bashkëbiseduan me Kryetarin e Bashkisë Niko Peleshi, me të cilin ndanë mendime dhe votuan prioritetet, të cilat ata i konsiderojnë më të rëndësishme në lagjen ku banojnë.

Ky model i hartimit të buxhetit konsiderohet i një rëndësie të veçantë nga Bashkia Korçë, pasi nga njëra anë Bashkia bën transparencën me qytetarët dhe nga ana tjetër, qytetarët thonë fjalën e vet se ku duhet të shkojnë lekët e taksapaguesve korçarë.

# Komisioni qytetar

*verifikan*



## objektet e propozuara në terren

**V**erifikimi në terren i objekteve të propozuara nga qytetarët në takimet e Buxhetimit me Pjesëmarrje, përbëjnë Fazën e Dytë të këtij procesi mjaft të rëndësishëm, mbi bazën e të cilit do të hartohet edhe plani i investimeve të Bashkisë Korçë për vitin 2010. Ky hap më pas do të pasohet nga një tryezë diskutimi, ku krahas Komisionit Qytetar dhe specialistëve të fushës do të ftohen të marrin pjesë edhe anëtarë të Këshillit Bashkiak.

E veçanta e këtij viti do të jetë, ndjekja e procesit të realizimit të këtyre projekteve nga përfaqësuesit e Komisionit Qytetar në terren, për çdo objekt të financuar.

# Bulevard Republika

Puna vazhdon...

**M**e shtrimin e pllakave të para të kuarcit, Bulevard "Republika" ka transformuar pamjen e saj, duke marrë një pamje të hijshme, krejt të ndryshme nga ajo çka jemi mësuar të shohim gjatë tërë këtyre viteve në qytetin tonë. Bulevard "Republika", është investimi më i madh dhe më i rëndësishëm i Bashkisë Korçë për vitin 2009 .

Gjatë muajve shtator –tetor, u punua me intensitet për rikonstrukcionin e këtij aksi. Shtrati i këtij bulevardi, iu nënshtrua një sërë procesesh përgatitore, ku pas gërmimit të dheut, u hodhën shtresa e çakullit dhe ajo e betonit dhe filloi menjëherë vendosja e pllakave. Deri në fund të muajit tetor, shtrimi me pllaka vijoi mjaft shpejt, duke u përfunduar më tepër se gjysma e gjatësisë së tij. Në këtë aks, i cili ka një qarkullim mjaft të madh, po punohet me segmente, duke iu ardhur kështu në ndihmë lirisë së qarkullimit të kalimtarëve edhe të automjeteve.

Kryetari Bashkisë Niko Peleshi, falenderon të gjithë qytetarët korçarë, në veçanti ata që banojnë përgjatë këtij bulevardi për mirëkuptimin dhe besimin për këtë investim, i cili pavarësisht vështirësive të momentit, do të jetë mjaft fitimprurës për bizneset që e shtrijnë aktivitetin e tyre përgjatë kësaj shëtitoreje.

# Shkolla e Re

*çel dyert*

në ditën e parë të shkollës

Më 14 shtator, ditën e parë të shkollës, Kryetari i Bashkisë Niko Peleshi ka shkuar mes nxënësve, mësuesve dhe prindërve të Shkollës së Re, të cilët këtë vit do të zhvillojnë procesin mësimor në ambiente krejtësisht të reja.



Ka qenë investimi i qeverisë shqiptare që ka mundësuar ngritjen e kësaj shkolle të re në qytetin e Korçës, një ambient tërësisht bashkëkohor, me klasa e palestër mjaft komode, si dhe sallë kompjuterash e laboratorë të pajisur me të gjitha kushtet.

# Bashkia investon *në terrenet sportive* të shkollave

Bashkia e Korçës është duke investuar në terrenet sportive të shkollave të qytetit. Pas rikonstruksionit me fondet e veta të palestrës së Shkollës "Sotir Gurra" në fund të shtatorit përfundoi edhe shtrimi me parket i palestrës së Shkollës "Stavri Themeli".

Kthimi në identitetin e terreneve sportive është pjesë e programit "Sport për të gjithë", i cili parashikon ndërtimin e terreneve sportive në lagjet e qytetit. Bashkia do të ndryshojë filozofinë me të cilën është punuar deri tani duke hapur ato edhe në orët e pasdites si për profesionistët edhe për amatorët.

Me shfrytëzimin sa më eficient të këtyre terreneve, do të mund të afrohen të orientohen të rinjtë drejt aktiviteteve të shëndetshme siç është sporti dhe nga ana tjetër, do të rritet cilësia sportive në të gjitha nivelet.



# Pas investimit të Bashkisë, aneksi i stadiumit

gati për tapetin e gjelbër

Sistemohet  
Shëtitore "Fan Noli"

Në fund të muajit shtator, përfundoi sisemimi dhe asfaltimi i Shëtitore "Fan Noli". Investimi u realizua me fondet e Bashkisë Korçë, me vlerën 5 milion lekë.

Me fondin prej 9 milion lekësh nga të ardhurat e veta, Bashkia e Korçës përfundoi rikonstrukcionin e aneksit të Stadiumit "Skënderbeu" të qytetit. Investimi përfshiu të gjitha punimet e gërmimit dhe drenazhimit të fushës, si dhe ngjeshja dhe rrethimi i saj duke u bërë gati për shtrimin e tapetit të gjelbër nga Federata Shqiptare e Futbollit.

Në një sipërfaqe prej 10 mijë m<sup>2</sup>, më të madhe se ajo e stadiumit, do të stërviten të gjitha ekipet zinxhir të futbollit korçar. Gjatë inspektimit të punimeve, Kryetari i Bashkisë Niko Peleshi u shpreh se pas krijimit të këtyre kushteve sipas standarteve ndërkombëtare, Bashkia e qytetit beson në rezultate më optimiste nga futbollit korçar. Me parametrat që ka, fusha do të mirëpresë edhe takime ndërkombëtare.

# SISTEMIM dhe lulishte E RE në Lagjen 10

**P**as prishjes së disa rrethimeve pa lejë të banorëve të bllokbanimi në Lagjen 10 të qytetit të Korçës, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike realizoi sistemimin e sheshit dhe ndërtimin e lulishteve në të. Ky bllokbanimi, që prej krijimit të tij nuk ka pasur asnjëherë një zonë të tillë të gjelbëruar. Po punohet për plotësimin e këtyre lulishteve me sipërfaqe të gjelbër, barin, bimësinë e ulët dhe do të vazhdojë gjatë muajve nëntor e dhjetor me mbjelljen e pemëve.



# INTENSIFIKOHEN punimet në rrugicat e Lagjes 7



**K**a përfunduar më tepër se gjysma e asfaltimit të rrugëve të Lagjes 7 në qytetin e Korçës. Me fondin prej 29 milion lekësh, të fituar nga Bashkia Korçë nga grandet konkurruese të qeverisë shqiptare, punimet për sistemimin dhe asfaltimin e rrugëve në këtë lagje kanë filluar në muajin maj të këtij viti. Gjatë këtyre dy muajve janë sistemuar e asfaltuar rrugët Alush Koprencka, Bajram Curri e Asim Vokshi dhe po punohet në rrugën Duka Luarasi.

# Plani Rregullues i qytetit i besohet ekspertëve izraelitë

Ekspertë të studios izraelite Lerman Architects Plans and Regulations, të cilët fituan të drejtën nëpërmjet qeverisë shqiptare për hartimin e Planit Rregullues –Urbanistik të qytetit të Korçës të financuar nga Banka Botërore zhvilluan një tur studimor në qytetin e Korçës.

Ky është takimi i tretë i Bashkisë Korçë me ekspertët, këtë herë i shoqëruar me takime të tjera me drejtues të sektorëve në bashki edhe me prezencën e institucioneve më të rëndësishme në qytet si KESH, UKKO, ALB Telecom, Këshilli i Qarkut, REC etj. Kryetari i Bashkisë Niko Peleshi prezantoi vizionin dhe potencialet humane dhe ekonomike që qyteti ka duke iu përgjigjur edhe pyetjeve të ekspertëve.

Plani Rregullues, - tha Kryebashkiaku Peleshi, -do të jetë pasqyrim i tendencës së zhvillimit ekonomiko-shoqëror të qytetit. Me të, do të shtrohen shinat për qytetin e së nesërmes. Plani do të mbajë parasysht masterplanin e qendrës së qytetit të hartuar nga studioja gjermane Bolles & Wilson në Konkursin Ndërkombëtar për Qendrën e Korçës të zhvilluar në muajin korrik të këtij viti. Afati për dorëzimin e Planit Rregullues të përfunduar është shtatori i vitit të ardhshëm.



## Ngrihet

## Info Point

### pika e parë e informacionit turistik në Korçë

Info Point, struktura moderne e ngritur në krah të katedrales së qytetit, do të jetë busulla e orientimit për të gjithë turistët në drejtim të atraksioneve turistike të qytetit. Info Point paraqet hartën e qytetit, duke ofruar për të gjithë turistët vendas e të huaj një informacion të detajuar për të gjitha atraksionet turistike, monumentet e kulturës, bare e restorante, festa dhe gjithçka tjetër me interes për t'u vizituar së bashku me një përshkrim të shkurtër për to në dy gjuhë, shqip dhe anglisht. Nga kjo pikë qyteti i Korçës lehtëson guidën e vizitorëve duke prezantuar veten me të gjitha vlerat që ajo mbart. Info Point u realizua si rezultat i iniciativës së Bashkisë së qytetit me mbështetjen financiare të USAID. Shumë shpejt kjo do të pasohet me një tjetër pikë, e cila do të jetë rajonale duke përfshirë një informacion më të zgjeruar për rajonin. Njëkohësisht, brenda muajit dhjetor do të çelët edhe Zyra e Informacionit Turistik.

# YES *Shërbime punësimi për të rinjtë*

**YES** –Shërbime Punësimi për të Rinjtë është programi më i ri, i cili nëpërmjet një përpjekje të koordinuar të partnerëve synon punësimin e të rinjve duke rritur aftësitë e tyre përballë tregut të punës dhe përmirësimin e shërbimeve ndaj tyre. Prezantimi i kësaj iniciative u bë në një tryezë të përbashkët të aktorëve që janë përfshirë në këtë projekt ku bëjnë pjesë Agjensia Rajonale e Zhvillimit në cilësinë e implemtuesit në partneritet me Bashkinë e Korçës, Universitetin “Fan S Noli”, Zyrën Rajonale të Punësimi, Shoqatën Rinore “Fusion” dhe Klubin Rotarian.

Në fjalën e tij, Kryetari i Bashkisë së qytetit Niko Peleshi vlerësoi me mjaft rëndësi përfaqshjen e kërkesave të tregut të punës dhe tendencat e zhvillimit të biznesit, me programet universitare dhe ato pasuniversitare. Ai kërkoi të themelohet një program i qëndrueshëm me buxhet të garantuar, ku të rinjtë të gjejnë derë për të trokitur për mundësi kualifikimi e rikualifikimi, në përshtatje me kërkesat e tregut të punës.

## NDIHMJA *për të rinjtë dhe biznesin lokal* sfida e qytetit

**B**ashkia e Korçës do të verë në dispozicion të YES Fondin Social, do të trajtojë e do të përgatisë këta të rinj me planet e biznesit ashtu si edhe vitin e kaluar nëpërmjet programit të saj YEP.

Programi i Bashkisë Korçë gjatë vitit të kaluar rezultoi i suksesshëm. Nëpërmjet tij u mbështetën 10 biznese të reja me grande nga Bashkia, aktiviteti i të cilave rezultoi të vijojë normalisht, si dhe me ndihmën e tij, 20 të rinj të tjerë u punësun në sektorin privat. Këtë vit, programi është më i madh dhe me objektiva më ambiciozë pasi ka mbështetjen e SORROS, ROTARY e FUSION .

Në mbështetje të këtij programi Bashkia do të vazhdojë të ofrojë, lehtësi për bizneset e reja

Tarifë regjistrimi ZERO

Taksa e tarifa më të ulta



Pranë Bashkisë kanë filluar regjistrimet për të gjithë të rinjtë që kanë mbaruar studimet e larta në Fakultetin Ekonomik, të cilët po aplikojnë për të qenë pjesë e këtij projekti që synon:

- Trainimin e 100 të rinjve sipas kërkesave të tregut të punës
- Punësimin e këtyre të rinjve pranë biznesve lokale
- Çeljen e 12 bizneseve të reja nga të rinjtë

# 25 maturantët e shkëlqyer marrin kompjuter falas nga Bashkia

Edhe këtë vit, Bashkia stimulon maturantët më të mirë të shkollave të mesme të Korçës. 25 maturantët e shkëlqyer të shkollave të mesme të qytetit të Korçës kanë marrë një kompjuter dhuratë nga Bashkia e qytetit. Në ceremoninë e rastit Kryetari i Bashkisë Niko Peleshi, përgëzoi dhe uroi nxënësit por edhe prindërit e tyre për rezultatet e shkëlqyera në procesin mësimor dhe më pas u dha çertifikatën e mirënjohjes.



## kurset e të talentuarve rikthehen edhe gjatë 2009-ës

“**Artistët e vegjël**” rikthehet edhe gjatë 2009-ës për të gjithë fëmijët e talentuar të qytetit të Korçës. Pas një ekperience të suksesshme gjatë vitit të kaluar, Bashkia Korçë, në kuadër të programit Qyteti për fëmijët, çeli edhe gjatë këtij viti kurset “Artistët e vegjël”, një mundësi mjaft inkurajuese për fëmijët e talentuar për të zhvilluar talentin e tyre me ndihmën e profesionistëve. Kurseve të vizatimit, poçerisë, kitarës, baletit dhe fotografisë që ishin edhe vitin e kaluar, me kërkesën e fëmijëve dhe të prindërve, u është shtuar këtë vit edhe kursi i aktrimit. Kërkesat e fëmijëve kanë qenë mjaft të larta, por pas fazës përzgjedhëse, kursin e vizatimit do ta vazhdojnë fëmijët e talentuar.

# Ekspozohen fotografitë

e edicionit të dytë

të Shkollës Verore të Fotografisë

Mbi 40 fotografi të studentëve të Shkollës Verore të Fotografisë u ekspozuan më 18 shtator në Galerinë "Guri Madhi" pranë Qendrës Kulturore "V.Mio".

Ky është viti i dytë që Bashkia e qytetit aplikon këtë projekt, duke nxitur të rinjtë të eksplorojnë qytetin nëpërmjet aparatit fotografik, të kërkojnë tematika të reja, duke i kthyer ato në artin e bukur të fotografisë, për të cilën qyteti ynë ka një traditë të pasur.

Fotografitë e ekspozuara, me tematikë të ndryshme dhe krejtësisht të lirë, spikatën për këndvështrime të shumëllojshme dhe përpunim artistik të ideve.

Në përfundim të kësaj shkolle Bashkia Korçë synon të nxjerrë një gjeneratë të rinjsh që e duan qytetin duke dokumentuar trashëgiminë e pasur kulturore dhe arkitektonike.



# Karta 16-24

së shpejti në dorën e të rinjve korçarë

Të rinjtë e moshës 16 – 24 vjeç, do të pajisen me Kartën Rinore 16/24 dhe do të përfitojnë facilitete në shërbime dhe mallra, si në sektorin publik ashtu dhe në atë privat. Bashkia Korçë do të implementojë së shpejti Projektin "Karta 16/24" sipas të cilës, të rinjtë e pajisur me këtë kartë do të mund të përfitojnë ulje çmimesh për transportin urban, hyrjen në teatër, stadium, kinema, bare e restorante, laboratore fotografike, njësi të tregëtimit të materialeve shkollore etj.

Nëpërmjet këtij projekti, Bashkia Korçë synon ndër të tjera nxitjen dhe gjallërimin e jetës social -kulturore të të rinjve të qytetit dhe motivimin e tyre për të studiuar dhe jetuar në qytetin e Korçës.

# Karta 16-24



DATËLINDJA 22/06/1987



E VLEFESHME DERI NË MOSHËN 24 VJEÇ

Karta nr: 21  
www.bashkiakorce.gov.al

## Pallati i Sportit "Tamara Nikolla" -arena e ndeshjeve për Eleminatoret e Kampionatit European në basketboll për meshkuj

Pallati i Sportit "Tamara Nikolla" ka mirëpritur një prej ndeshjeve për Eleminatoret e Kampionatit European në basketboll për meshkuj. Fusha e Korçës është përzgjedhur nga Federata Shqiptare e Basketbollit për zhvillimin e kësaj ndeshje ndërkombëtare, duke i dhuruar sportdashësve korçarë një ndeshje plot emocione, një festë e cila prej vitesh i ka munguar sportdashësve të qytetit.

# Qendra e dytë ditore për të moshuarit,

*u uron mirëseardhjen banorëve të saj*

**N**ë 1 Tetor, Ditën Ndërkombëtare të Moshës së Tretë është çelur në Korçë Qendra Ditore për të Moshuarit, e dyta e këtij lloji në qytetin tonë. Në përurimin e saj ishin prezent Kryetari i Bashkisë së Korçës Niko Peleshi dhe Hartmut Puerner, Drejtor në Departamentin e Demokratizimit dhe Shoqërisë Civile pranë OSBE . Ka kaluar rreth 1 vit e gjysëm që prej hapjes së qendrës së parë në Laçjen 12 të qytetit dhe Bashkia synon hapjen e disa qendrave të tilla në laçjet periferike të qytetit, në mënyrë që ato të jenë sa më pranë banesës së këtyre të moshuarve.

Qendra Ditore e Moshës së Tretë është pjesë e programit "Qyteti social" të Bashkisë dhe synon mbështetjen e grupeve në nevojë duke përmirësuar cilësinë e jetës së tyre.

Nëpërmjet këtij programi, Bashkia në bashkëpunim me shoqërinë civile kërkojnë të edukojnë dhe të nxisin së bashku një model bashkëpunimi dhe anëzdhimi qytetar në të mirë të komunitetit.

Kjo qendër u hap me iniciativën e Bashkisë Korçë në partneritet me Qendrën e Zhvillimit të Shoqërisë Civile dhe OSBE, si dhe me kontributin e Shoqatës së Serenatistëve Korçarë dhe njësisë treçetë NEPTUN.

Qendra do t'ju ofrojë të moshuarve kafe e çaj falas, leximin e shtypit të ditës dhe kontroll mjekësor falas, lojra arëtuuese, të gjitha në një mjedis mjaft mikpritës.

## 104 familje korçare

**përfitues të kredisë për banesë sociale me kosto të ulët**

### **Pritet vendimi i bankës**

104 familje korçare të pastreha, me vendim të Këshillit Bashkiak, do të përfitojnë kredi të zbutur nga shteti për blerjen e banesës sociale me kosto të ulët. Në bazë të marrëveshjes me qeverinë shqiptare, familjet përfituese do të paguajnë vetëm 3% të vlerës së kredisë. Por për shkak të vlerës 140% të kolateralit, një pjesë e familjeve nuk është në gjendje të blejë një banesë në treç qoftë ky një ndërtime i vjetër. Kjo ka bërë që Këshilli Bashkiak të miratojë një numër të pakët familjesh krahasuar me kërkesat dhe nevojat e qytetarëve korçarë për strehim, e cila do t'i nënshtrohet seleksionimit të dytë të bankës. Sektori i Strehimit në Bashkinë Korçë po vazhdon punën për regjistrimin e aplikimeve të reja nga familjet, të cilat do të arrijnë t'i plotësojnë kushtet e vendosura.

# Libra dhe mjete shkollore falas

## *për fëmijët në nevojë*

**M**ë 14 Shtator, ditën e parë të shkollës, 100 fëmijë në nevojë, me kontributin e Bashkisë Korçë dhe organizatës « Terre des Hommes », kanë marrë çanta shkolle dhe një komplet me të gjitha mjetet shkollore falas. Për herë të parë dhe në ndryshim nga viti i kaluar, të gjithë fëmijëve të qendrës dhe mjaft fëmijëve të tjerë ne disa shkolla të qytetit, u janë blerë librat shkollore, duke synuar që këta fëmijë të ndjekin normalisht shkollën.



## Më shumë vëmendje dhe ndihmë nga komuniteti dhe biznesi



**M**e rastin e Ditës Ndërkombëtare Kundër Urisë, Zyra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve pranë Bashkisë me mbështetjen e Terre des Hommes, organizoi aktivitetin argëtues tek Bar "Richi" ku morën pjesë 50 fëmijë nga familjet në nevojë. Fëmijët përveç argëtimit drekuan së bashku ndërkohë që nga zyra, me rastin e kësaj dite, u dhuruan 70 xhupa dhe 70 palë atlete për fëmijët në nevojë.

Mesazhi i kësaj dite ishte për më shumë vëmendje dhe ndihmë nga komuniteti dhe biznesi për familjet dhe veçanërisht për fëmijët që jetojnë në varfëri.

# Mesazhe shprese në Ditën Ndërkombëtare të Kujdesit Paljativ



Në një atmosferë plot ngjyra, muzikë dhe gjallëri nëpërmjet krosit të organizuar me fëmijët e vegjël dhe nxënësit e shkollave 9-vjeçare, bluzat e bardha të Qendrës së Kujdesit Paljativ në Korçë përcollën mesazhin e shpresës në Ditën Ndërkombëtare të Kujdesit Paljativ. Nëpërmjet fletëvolanteve, qytetarët u përfshinë në fushatën e ndërgjegjësimit për diagnostikimin e hershëm të sëmundjeve malinje dhe rëndësinë e kujdesit paljativ.

## Bashkia-Rotary Club

Në takimin të zhvilluar në Bashkinë e qytetit, Bashki -Rotary konfirmuan vazhdimin e bashkëpunimit mes tyre.

Krahas programeve të tjera që po zbatohen nga viti në vit, u diskutua edhe për bashkëpunimin në dy pista konkrete, pikërisht në shërbimin shëndetësor në drejtim të rikualifikimit të personelit dhe në fushën sociale, kryesisht në ndihmën që duhet t'i jepet moshës së tretë. Shërbimi social është ndër më prioritarët në programet e Bashkisë Korçë dhe për këtë janë hartuar projekte konkrete. Një ndër to është shtrirja e Qendrave Komunitare për Moshën e Tretë në çdo lagje të qytetit, sa më pranë banesës së këtyre njerëzve në nevojë, të cilët ndihen shumë të diskriminuar për shkak të mungesës së mjeteve financiare dhe vetmisë për të përballuar jetën.

## bashkëpunimi

do të konkretizohet në  
një dimension të ri social



# Kolonia Ndërkombëtare e Piktoreve

## “Ditët e Mios”

në edicionin e tretë



**B**ukuritë natyrore të Korçës edhe këtë vit frymëzuan penelin e piktoreve të ardhur nga vende të ndryshme të botës në Koloninë Ndërkombëtare të Arteve Figurative “Ditët e Mios”. Ky projekt, i cili e ka siquruar tashmë suksesin e tij që prej tre vjetësh, si një bashkëpunim i Bashkisë së qytetit me Qendrën Kulturorë “Vançjush Mio” solli në Korçë emra të rinj e të vjetër, artistë të afirmuar ndër të cilët Skënder Kamberi, Buron Kaceli, Xhaneta Kadillari etj. Kolonia përfshiu 40 piktoret pjesëmarrës, 10 prej të cilëve nga Qarku i Korçës, 3 pedagojë nga Prishtina dhe 15 piktore të tjerë nga trevat e tjera shqiptare. Për artistët pjesëmarrës krijimet e këtij viti shënuan një rritje cilësore krahasuar me dy vitet e para, duke i siquruar kolonisë vazhdimësi të suksesshme.

Një tjetër ngjarje e rëndësishme që do të pasojë Koloninë e Piktoreve është ajo e muajit dhjetor, Konkursi Mbarëkombëtar i Pikturës “Vançjush Mio” Në të u ftuan të marrin pjesë krahas pjesëmarrësve të kolonisë edhe piktore të tjerë.

## O ç'bëhet kështu!



## shfaqje varjete në Teatrin "Çajupi"

Premiera e shfaqjes varjete me numor dhe këngë "O ç'bëhet kështu" është shfaqur për publikun korçar më 30 gusht duke vazhduar për disa ditë me radhë në sallën e Teatrit "Andon .Z.Çajupi".

Humori dhe satira dhe kënga janë përcjellë për publikun nëpërmjet interpretimit të aktorëve Arben Dervishi, Zamira Kita, Albano Prodani, Xhensila Muhadiri dhe këngëtares Ermira Babaliu.

## Vepra të Galerisë "Iris" nga qyteti i Shkodrës ekspozohen në Korçë

Një bashkëpunim mes dy galerive, Galerisë "Guri Madhi" në Korçë dhe Galerisë "Iris" e qytetit të Shkodrës kanë sjellë për artdashësit e arteve figurative të qytetit tonë një ekspozitë me piktura, skulptura dhe foto nga Shkodra.

Nga 80 punët e ekspozuara, 40 prej tyre ishin fotografi të fotografit Fatmir Trashani, ndërsa 40 të tjera, ishin piktura dhe skulptura nga fondi i Galerisë "Iris".

## "Me miqtë në vite", koncert me këngët e nostalgjisë nga Spiro Katundi

Në Teatrin "A.Z.Çajupi" të qytetit, artdashësit iu rikthyen nostalgjisë së viteve në koncertin recital të titulluar "Me miqtë në vite" me krijime nga At Spiro Katundi.

Në skenë këngët u interpretuan nga të mëdhenjtë e muzikës së lehtë shqiptare Luan Zhegu, Tonin Tërshana, Bashkim Alibali, Kozma Dushi, me pjeëmarrjen e këngëtarëve më të njohur korçarë Gjergji Suljoti, Vëllezërit Prifti, Fatbardha Hoxha, Zhuljeta Sheremeni, Namik Bebri, Vaskë Jani, Emi Poreci, Kompleksi i Burrave.

# Mbrëmje Muzikore “Nga Folku tek Jazz”

Pas suksesit të një viti më parë, Formacioni Orkestral “Dixie Band” (Saint Maria) me udhëheqës artistik Josif Minga, organizoi edhe këtë vit Mbrëmje Muzikore “Nga Folku tek Jazz”. Morën pjesë Formacioni Orkestral Popullor i Festivalit Folklorik Kombëtar të Gjirokastrës dhe Dixie –Band (Saint Maria).

## Ekspozite

*nga Thoma Zhidro*

Në 7 tetor, Bashkia Korçë, Qendra Kulturore “V.Mio”, Galeria e Arteve “G.Madhi” çelën ekspozitën e artistit Thoma Zhidro.



## Peisazhe

*nga Sotiraq Kuçali*

Piktori Sotiraq Kuçali ekspozoi për artdashësit në Galerinë “G.Madhi”, 40 piktura të gjinisë së peisazhit të realizuara në vaj dhe akrelik.

Ekspozita qëndroi e hapur deri në datën 10 tetor.

## 110 vjet Lasgush PORADECI- Liriku i dhimbjes së bukur


“Fluturoi dhe shtërgu i fundit” u titullua mbrëmja poetike e zhvilluar në Bibliotekën “Th.Mitko” me rastin e 110 –vjetorit të lindjes së lirikut të madh shqiptar, poetit Lasgush Poradeci. Vargjet e lirikut të madh erdhën për të ftuarit e kësaj mbrëmje, nëpërmjet fjalës poetike të aktorëve të Teatrit “Çajupi”, kujtimeve të miqve dhe të vajzës së tij Maria dhe kritikët Muharem Xhaxho dhe Mehmet Gëzhilli. Në hollin e bibliotekës u ekspozua e gjithë galeria e krijimtarisë së poetit të madh.

# SONDAZHE

## QYTETARËT JANË PYETUR...

### Sondazh me banorët e zonës së qendrës

Nëse janë dakord që të ndërtohen objekte të reja në zonën e tyre dhe nëse pranojnë të bëjnë menaxhim në grup të pronave të tyre.



### TË TJERA ...

→ Sondazh me banorët e ish MAPO  
Për rikonstrukcionin e fasadës së banesës së tyre.

→ Sondazh me banorët e Lagjes 13  
Për mënyrën e ndërtimit në bllokbanesat e tyre.

→ Sondazh me banorët e pallatit përballë kinemasë  
Për mbylljen e vendgrumbullimit të mbeturinave poshtë shkallëve dhe hedhjen e tyre në kontenerët përgjatë Bul. "Republika".

*Orientohemi duke pyetur qytetarët*

# Fjalën e ke ti!

## Sondazhi elektronik i Bashkisë Korçë



Jepni opinionin tuaj duke klikuar në faqen zyrtare të Bashkisë Korçë

[www.bashkiakorçe.gov.al](http://www.bashkiakorçe.gov.al)

### "Qyteti im" në duart tuaja

- A e dini se "Qyteti im" mund ta gjeni në pikat e tregëtimit të shtypit?  
Tek njësia përballë shitjes së ujit  
Tek Pazari  
Bul. "Republika", Libraria në krah të Bankës Greke  
Libraria tek ish Vetëshërbimi  
- A e dini se "Qyteti im" mund ta keni në e-mail-in tuaj?  
Na shkruani e-mail-in tuaj në adresën tonë:  
[qyteti.im@bashkiakorçe.gov.al](mailto:qyteti.im@bashkiakorçe.gov.al)  
- A e dini se "Qyteti im" mund ta gjeni në faqen zyrtare të Bashkisë Korçë  
[www.bashkiakorçe.gov.al](http://www.bashkiakorçe.gov.al)

## Meritojnë falenderimin tonë... Deserve our gratitude...



**OSBE dhe CSDC** për mbështetjen në çeljen e Qendrës Ditore për Moshën e Tretë, e dyta në qytetin tonë.

**OSCE and CSDC** for their support in opening the the second Elder's Day Center in our city.



**PIKTORËT E KOLONISË NDËRKOMBËTARE** "Ditët e Mios" që për të tretin vit me rradhë, fiksojnë bukuritë e qytetit të Korçës në telajot e tyre.

**INTERNATIONAL COLONY OF PAINTERS** "Mios Days" that for the third year clinch the beauty of our city in their beautiful paintings.



**QYTETARËT E KORÇËS** për pjesëmarrjen dhe mendimet e tyre të vlefshme në takimet e Buxhetimit me Pjesëmarrje, të cilat do ta ndihmojnë Bashkinë për të investuar sa më drejt në përputhje me nevojat e qytetarëve.

**CITIZENS OF KORÇA** for their participation and valuable opinions in the Participatory Budgeting meetings, which will help the municipality to invest more in accordance to the needs of citizens.



**ARZH, ROTARY SORROS, FUSION,** për mbështetjen në çeljen e YES-Shërbime Punësimi për të Rinjtë, i cili do të ndihmojë të rinjtë e qytetit tonë, të orientohen me kërkesat e tregut të punës për të hapur një biznes në qytetin e tyre.

**ARZH ROTARY SORROS, FUSION,** for the support to the opening of YES-Youth Employment Services, which will help our city's youth, to navigate the job market requirements to open a business in the city.

## Kolonia e piktorëve



### Përgatitën:

*Ana Qeramixhi  
Benila Tërova  
Sofjola Kotelli*

### Ndihmuan:

*Stafi i Bashkisë  
Korçë  
Ndërmarrja e  
Shërbimeve Publike  
Pallati i Kulturës  
"V.Mio"  
Teatri "A.Z.Çajupi"*

*Për një qytet ku bashkëjeton tradita me modernen, ku të rinjtë realizojnë aspiratat e tyre për shkollim dhe punësim, ku të moshuarit jetojnë ditë të bardha, një qytet që ka gjithmonë një dorë të zgjatur për të nxjerrë nga vështirësia dhe ku problemi yt gjen një zgjidhje. Pas një kthese ecim me vrull në një drejtim të ri për të kapur kohën e humbur dhe për të dalë në krye siç i ka hije Korçës. Ky është identiteti ynë i ri.*

### Fotot nga:

*Ana Qeramixhi  
Vaskë Niço (Billi)  
Studio "Xhimi"  
Studio "Alvin"*

### Design:

*trinqpoint®*

## Mbështesni "Qyteti im"



Për më tepër informacion:

Tel: 082 245755

e-mail: [qyteti.im@bashkiakorçe.gov.al](mailto:qyteti.im@bashkiakorçe.gov.al)

[bashkiko@albmil.com](mailto:bashkiko@albmil.com)

[www.bashkiakorçe.gov.al](http://www.bashkiakorçe.gov.al)